



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:284011
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05602734

K.Dh.Sh.II.nr.972/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Franciska Zhitija dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “A.Sh.” BI me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1911/19 të datës 03.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.1911/19, i datës 03.06.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.1911/19, të datës 03.06.2021, në pikën I të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “A.Sh.” BI me seli në Prishtinë, në pikën II të dispozitivit anulohet aktvendimi me nr.01.3.2.2/532/2017 i datës 09.07.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “A.Sh.” BI me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 1,461.14€ (njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një euro, e katërmëdhjetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit, të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R33968/06.07.2017, të proceduar në Zyrën Doganore Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të ankesës tek e paditura 04.08.2017, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi A.nr.1911/19 i datës 03.06.2021 si i pa bazuar në ligj, të

refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e pabazuar ne ligj dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar ose t'ia kthej gjykatës në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar paditësi përmes të cilës ka kërkuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pabazë dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar nga ankesa e të paditurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/532/2017 të datës 09.07.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë A.Sh. BI - Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit R-33968/06.07.2017 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit “A.Sh.” BI me seli në Prishtinë, t'ia kthej shumën prej 1,461.14€ (njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një euro, e katërmëdhjetë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit, të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R33968/06.07.2017, të proceduar në Zyrën Doganore Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të ankesës tek e paditura 04.08.2017, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në arsyetimin e aktgjykimit kontestues është theksuar se Gjykata konstaton se paditësi në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë konflikt administrativ, për të provuar vlerën doganore të mallit-automjetit të importuar i ka paraqitur gjykatës si provë për DUD-in R-33968/06.07.2017, faturën e blerjes së mallit në vlerë fillestare me nr.174142 të datës 13.06.2017, në shumë neto prej 12,168.07€ dhe në shumë bruto të përgjithshme prej 14,510.00€, ku është përfshirë edhe TVSH-ja e llogaritur në vlerë prej 2,316.72€, faturën e blerjes së mallit me nr.174142 të datës 14.06.2017, në shumë prej 12,168.07€, transaksionin bankar të datës 13.06.2017 për eksportuesin e mallit “Das Autohus” AG, në shumë prej 14,510.00€, me përshkrimin bankar “BMW320D nr..... Carno.1948, Costino 1281594”, dokumentin me nr.1281594 të datës 14.06.2017 në vlerë prej 2,316.72€, shkresën e datës 13.06.2017 të lëshuar nga eksportuesi për paditësin për depozitim të TVSH-së, për shtetet jo anëtare të BE-së, dëshminë bankare të datës 05.10.2017, me të cilin vërtetohet se paditësit i është kthyer shuma e depozituar në emër të TVSH-së në shumë prej 2,311.72€. Krahas këtyre dokumenteve, paditësi

për të dëshmuar vlerën e automjetit ka paraqitur edhe deklaratën eksportuese nga shteti eksportues Gjermania të datës 20.06.2017, kontratën e shitblerjes të datës 13.06.2017, ofertën nga interneti për veturën e blerë nga shitësi-eksportuesi “Dat Autohus” AG nga Gjermania, nga ku vërehet se të gjitha këto dokumente janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës së transaksionit të kryer, sipas nenit 33 par.1 të KDAK-së. Tutje është theksuar se në asnjë dispozitë ligjore të legjislacionit doganor të aplikueshëm nuk parashihet se vlera doganore e mallrave të importuara, duhet të jetë në përputhje me vlerën të dhënave të disponueshme apo vlerën e mallrave në katalogun gjerman “Schwacke Liste”, siç ka arsyetuar e paditura në vendimin e kontestuar, por përkundrazi tek neni 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”. Në gjendje e tillë e çështjes, gjykata si përfundim vlerëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se pagesa bankare nuk është bërë duke specifikuar faturën apo urdhër porosinë e mallit, këtë pretendim e Kolegji i kësaj gjykate e refuzon si të pa bazuar, pasi që transferi bankar i datës 13.06.2017 në përshkrimin e tij përmban të dhëna të sakta të veturës së importuar, përkatësisht llojin e veturës BMW320D dhe numrin WBA3K510K62690, të dhëna këto të cilat janë në harmoni të plotë me të dhënat e faturës së datës 13.06.2017 në vlerë bruto prej 14,510.00€, me deklaratën eksportuese të lëshuar nga shteti eksportues dhe më librezën e qarkullimit të veturës. Ndërsa fatura e datës 14.06.2017 me nr.VR0023902 të cilës i referohet e

paditura është faturë në të cilën është shënuar vlera neto e mallit 12,168.07€, kurse paditësi ka paguar vlerën bruto të mallit, përkatësisht faturën e datës 13.06.2017, e që pastaj me dokumentin e datës 14.06.2017 është bërë kthimi i TVSH në vlerë prej 2,316.72€.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.972/22, me datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova